



Development and Implementation of MDTV Curricula (DIMTV)

WP2.5 - Activity 2.5.2

Praktikat e studentëve

Project Duration: Oct 2017 – Oct 2020 (extended to October 2021)

Start Date of Deliverable: January 2019

Submission Date of Deliverable: September 2021

Dissemination level: Department / Faculty; Institution; Local; National

Lead Organization: UAMD

Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".



1. Hyrje

Një aspekt shumë i rëndësishëm i projektit DiMTV është edhe realizimi i praktikave mësimore për studentët. Për të realizuar këto praktika janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi me radio-televizione apo edhe kompani të sektorit privat që operojnë në fushën e multimedias në Shqipëri dhe Kosovë. Çdo memorandum duhet të përfshijë mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e praktikave mësimore të lidhura me MTVD.

Shpesh herë janë realizuar praktika me kompani për angazhimin e ekspertëve të industrisë si lektorë të ftuar. Të gjithë partnerët nga Kosova dhe Shqipëria kanë bashkëpunuar për të krijuar marrëdhënie të forta dhe të qëndrueshme midis universiteteve dhe industrisë.

Në kuadër të kësaj pakete pune janë realizuar edhe praktikat e studentëve me partnerë të industrisë. Studentët e padiplomuar dhe të diplomuar në MTVD do të duhet të kryejnë këtë praktikë përpara se të përfundojnë studimet e tyre.

Angazhimi i ekspertëve të industrisë në mësimdhënie do të realizohet duke organizuar leksione të hapura me ekspertë të industrisë ose forume të hapura në institucionet e arsimit të lartë. Në varësi të temave të trajtuara, leksionet janë organizuar në kuadër të një kursi të caktuar, ose si leksione të lidhura me një program studimi në tërësi.

Praktikat e realizuara në kuadër të DiMTV, u kanë siguruar studentëve jo vetëm njohuritë e nevojshme bazë teorike por dhe i kanë aftësuar ata për përdorimin e software dhe tools të ndryshme që mund ti përdorin në të ardhmen në vendin e punës. Praktikantët u kanë mundësuar studentëve mjedisin e duhur për të aplikuar njohuritë teorike të marra gjatë mësimin. Të mësuarit në kushte reale të mjedisit të punës, i aftëson studentët dhe i përgatit ata për të qenë të konkurueshëm në tregun e punës.

2. Praktikët e studentëve gjatë implementimit të projektit DIMTV

Në kuadër të projektit DIMTV janë realizuar praktika profesionale për studentët e programeve të studimit në fushën e multimedias në universitetet e Ballkanit Perëndimor, në radio-televizionet dhe kompanitë private me të cilat janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi sipas raportit 2.5.1.

➤ **Praktika profesionale për studentët e Universitetit të Prishtinës në Radio-Televizionin Tema**

Pas marrëveshjes me Radio-Televizionin TEMA në Kosovë dhe Universitetit e Prishtinës, filluan të realizohen evente të përbashkëta. Studentët nga Universiteti i Prishtinës patën mundësinë të ndjekin një praktikë në Radio-Televizionin Tema. Studentët u njohën me aktivitetet, pajisjet dhe të gjitha proceset që ndodhin gjatë emisioneve që transmetohen në radio. Gjithashtu, ata patën mundësinë të mësojnë për produksionet e ndryshme dhe teknikat postproduksionit. Kjo praktikë do t'i ndihmojë studentët të bëjnë projekte praktike profesionale dhe të mësojnë rrjedhën e punës në studiot televizive.



Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".

➤ **Praktika profesionale për studentët e Universitetit Aleksandër Moisiu në Radio-Televizionin Shqiptar (RTSH)**

Radio-Televizioni Shqiptar, si partner i konsorciumit të projektit DIMTV, ka luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm në promovimin, realizimin e leksioneve të hapura por edhe ka ndihmuar që studentët e programit të studimit Multimedia dhe Televizion Dixhital të zhvillojnë praktikat profesionale në ambientet e televizionit dhe radios.

- ✚ Praktika e parë profesionale pranë ambienteve të RTSH është realizuar në kuadër të lëndës Produksioni dhe postproduksioni multimedial, që zhvillohet në vitin e tretë Bachelor në MTVD. Nën udhëheqjen e lektores Dr. Fatmira Prodani dhe mbështetjes së Ing. Armand Ndreca, një grup studentësh kanë vizituar ambientet e RTSH. Studentët kanë mësuar të gjitha hapat që ndiqen për të realizuar produksione të ndryshme gjatë një dite të zakonshme pune. Studentët kanë praktikuar aty të gjitha njohuritë e marra në këtë lëndë pasi. Kjo praktikë profesional në RTSH i prezantoi studentët me botën krijuese të teknologjisë dhe me komponentët e produkteve të bazuara në teknologjinë e komunikimit.



Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".



- ✚ Gjithashtu një grup tjetër studentësh kanë kryer praktikat profesionale pranë ambienteve të RTSH. Studentët të programit të studimit MTVD, Bachelor dhe Master Profesional ishin pjesë e një praktike në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH). Ata patën një eksperiencë përtej televizionit ku merron mësim praktikë dhe praktikuan role të ndryshme si teknik audio apo edhe teknik transmetimi të një emisioni. Në përfundim të këtij trajnimi studentët e programit të studimit Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital u pajisën me certifikata.



Me inaugurimin e dy laboreve moderne, studios audio-vizive dhe sallës së kompjuterave pranë ambienteve të UAMD, u hap një mundësi e re që studentët të kryejnë praktika jo vetëm në kompani të sektorit privat por edhe në ambientet e universitetit. Pajisjet tejet moderne dhe që përdoren për të mbuluar lëndët karakterizuese të multimedias janë kthyer në një mundësi e mirë jo vetëm për studentët e MTVD por dhe për të gjithë studentët e UAMD. Meqenëse këto labore i shërbejnë promovimit të universitetit dhe të gjitha eventeve që ndodhin, studentët e MDTV janë përfshirë shpesh në realizimin e spoteve publicitare, materialeve promovuese si edhe podcasteve të ndryshme.

Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".



- ✚ Studentët e Masterit Profesional në MTVD, në sajë të trajnimeve për pajisjet të zhvilluara nga lektorët e Universitetit të Lubjanës kanë arritur të perfeksionojnë përdorimin e pajisjeve në studio. Nën kujdesin e laborantes Uendi Çërma, ish studente e MTVD, ata kanë arritur të realizojnë transmetime live broadcast në studion e multimedias ku secili prej tyre ka patur role specifike në realizimin e produksionit final. Kjo eksperiencë i ndihmoi ata që të kuptonin mënyrën e lidhjes së pajisjeve audio dhe video për të realizuar transmetime të drejtpërdrejta dhe për të shmangur problemet e mundshme gjatë transmetimit. Për më tepër ndiqni videon në kanalën studentor në YouTube Multimedia TV: [MEDIUM - Broadcast studentor](#).



- ✚ Në kuadër të lëndës së animimit Stop Motion së bashku me lektoren e lëndës Dr. Fatmira Prodani, studentët kanë realizuar një workshop me të gjitha animimet që ata kanë realizuar.



Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".



Për më tepër ndiqni videot në kanalën studentor në YouTube Multimedia TV:

[Realizimi i StopMotion - Brikena Coku](#)

[Stopmotion- Elsa Hasbajrami](#)

[Paper Love Story - Anton Lleshi](#)

[M&M stopmotion - Vera Marku](#)

- ✚ Gjithashtu, me iniciativën e vetë studentëve të MTVD dhe përkujdesjes së Uendi Çermës, laborante pranë studios së multimedias, janë realizuar një seri podcastesh mbi tema të ndryshme çdo javë. Në këtë produksion të quajtur 4th Talk, ata kanë zgjidhur të përfshijnë jo vetëm studentët e këtij programi studimi por edhe studentët të tjerë të UAMD. Për më tepër ndiqni videot në kanalën studentor në YouTube Multimedia TV: [4thTalks Podcast - Promo](#)

- ✚ Një projekt bashkëpunim i frytshëm ndërmjet studios së multimedias dhe Teatrit Aleksandër Moisiu të Durrësit. Me ideimin e regjisores Driada Dervishi dhe me ndihmën në montazh të Uendi Çermës janë montuar "Letrën e Mbrëmjes". Një projekt që nuk mbetet vetëm tek aktorët profesionistë, por angazhon dhe dashamirësit e teatrit në botën magjike të interpretimit. Laboratori i multimedias ka qënë pjesë e produksionit dhe postproduksionit të këtyre letrave duke bërë të mundur që çdo mbrëmje të shfaqen online para publikut. Studentët bashkëpunuan në produksion dhe postproduksion e 48 filmave të shkurtër. Për më tepër ndiqni videot në kanalën e YouTube [Teatri ALEKSANDËR MOISIU](#).

- ✚ Për të dytin vit me rradhë, studio e multimedias në Universitetin "Aleksandër Moisiu" ishte pjesë e Balkan's Gate. Qëllimi i projektit është bashkëpunimi me të rinjtë, shkëmbimet kulturore dhe profesionale për të sjellë një kënd paksa të ndryshëm ose të përbashkët për shoqëritë relevante për sa i përket historisë, traditave dhe normave të Shqipërisë. Ky projekt i realizuar me AR Production bashkoi të rinj nga vende të ndryshme të cilët do të prodhojnë filma të shkurtër. Pas 10 ditësh kërkimi intensiv, vizualizimi, xhirimi dhe montimi, 7 studentë të MTVD nën mentorimin e regjisorit amerikan Nathaniel Hansen dhe Uendi Çërma realizuan dokumentarin "I SEE IT EVERYDAY". Për më tepër ndiqni videon në [Vimeo](#).



- ✚ Për shkak të marrëveshjes me New Americans Medias (NAM), u shtua një partner i ri edhe bashkëpunim me një gazetare që ka lindur në Shqipëri që tani jeton dhe punon në SHBA. New Americans Media (NAM), portali me bazë në SHBA (www.newamericansmedia.com), trajton problemet e emigrantëve në SHBA. NAM kërkoi dy praktikantë për të xhiruar 3 shfaqje në Shqipëri. Gazetarja Enkela Vehbiu tashmë është kthyer në Shqipëri për të prodhuar tre emisione. Në këtë rrugëtim ajo vendosi të mbështetet nga laboratoritë e multimedias ku studentët kanë regjistruar dhe montojnë produksionet. Ky projekt është akoma në zhvillim.



Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".

🚩 Workshop studentor tek UBT nga studentët e UAMD

Projekti i Erasmus+, “DIMTV” ka mbledhur në UBT profesorë e studentë nga programi “Multimedia dhe TV Digjital” në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, në Durrës, të cilët qëndruan për dy ditë dhe u takuan me udhëheqës e studentë të UBT-së.

17-18 Mars ishin data për t'u mbajtur mend për studentët e Masterit Profesional të MDTV. Studentët të shoqëruar nga tre profesorë shkuan për një vizitë të shkurtër në Kosovë, në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT). Ky takim shërbeu si një platformë për zgjerimin e bashkëpunimit mes dy institucioneve, gjithashtu pjesë e konsorciumit DIMTV. Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se kjo vizitë është vijimësi e krijimit të raportit të mirë mes UBT-së dhe UAMD-së, duke shtuar se bashkëpunimi vetëm se do të shkojë duke u forcuar.

Studentët gjatë vizitës së tyre shkuan në Kampusin Inovativ të UBT-së ku u themeluan studiot dhe laboratorët multimedialë. Ata patën një përvojë interesante duke biseduar me profesorë të UBT-së, studentë të tjerë nga Kosova dhe duke shkëmbyer përvoja. Në kampus, profesori Jeton Lakna ndau përvojën e tij në animacionin 3D, duke shpjeguar prodhime të ndryshme dhe postproduksion.



Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".